



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 1769 prot.,

Datë 27.04.2021

VENDIM

NR. 62, DATË 27.04.2021

PËR

**SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË TABELAVE PËRMBLEDHËSE TË
MONITORIMIT TË MBULIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE NGA OSHMA-TË
PËR PERIUDHËN 26 MARS - 23 PRILL 2021 SI DHE RESPEKTIMIN E
PERIUDHËS SË HESHTJES ZGJEDHORE**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Samir	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të tabelave përmbledhëse të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26 mars - 23 prill 2021 si dhe respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore.

Bazë Ligjore: Neni 19, pika 16, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 77 - 84 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive”,

VËREN SE:

Në zbatim të nenit 85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, AMA është ngarkuar me monitorimin e fushatës zgjedhore në mediat audiovizive.

Sipas kësaj dispozite ligjore:

1. Monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat audiovizive kryhet nga enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, AMA. Monitorimi kryhet në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet.
2. Enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë e operatorëve radiotelevizivë monitoron zbatimin e rregullave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore me karakter normativ

të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KQZ, nga operatorët radiotelevizivë dhe nga subjektet zgjedhore.

3. Jo me vonë se 3 muaj para datës së zgjedhjeve KQZ miraton dhe publikon Metodologjinë e Monitorimit të Medias.
4. Enti rregullator i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara, minimalisht të përjavshme, të cilat ia paraqet KQZ-së për kompetencë. Raportet shoqërohen, sipas rastit, me propozimet për masa administrative. Raportet e monitorimit të medias publikohen në faqen e internetit të KQZ-së menjëherë sapo depozitohen në KQZ. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejtë të depozitojnë komentet dhe propozimet e tyre para KQZ-së, të cilat shqyrtohen bashkë me raportin.
5. KQZ-ja urdhëron korrigjimin e sjelljes për operatorët radiotelevizivë ose subjektet zgjedhore, ose, sipas rastit, vendos sanksione administrative ndaj tyre, mbështetur në gjetjet e veta, në ato të raporteve të monitorimit, si dhe në informacionet, ankimet apo denoncimet e palëve të treta, të verifikuara prej saj. Vendimet e KQZ-së ankimohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të KQZ-së.

Komisioni Rregullator pranë KQZ-së, me vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 ka miratuar Metodologjinë e Monitorimit të medias audio dhe audiovizive, akt në të cilin parashikohen procedurat dhe teknikat që duhet të ndjekë AMA gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore.

Në nenet 9 dhe 10 të Metodologjisë përcaktohet përmbajtja e raporteve të monitorimit dhe paraqitja e tyre në KQZ. Në pikën 2 të nenit 10, po të këtij akti, parashikohet se *“AMA i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara (sasiore dhe cilësore), minimalisht njëherë në javë, të cilat ia paraqet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë”*.

Bazuar në kapacitetet teknike të monitorimit, gjatë fushatës zgjedhore janë monitoruar përmbajtjet programore të 36 OSHMA-ve (36 kanale). Nga këto, 27 kanale (TV 23 dhe radio 4) janë të përhershme në monitorim, ndërsa për cdo periudhë monitorimi janë përfshirë në monitorim subjekte OSHMA sipas përzgjedhjes nga ana e AMA-s, raportuar në KQZ. Subjektet e përfshira në monitorim ushtrojnë veprimtari audiovizive mbështetur në platformë tokësore, satelitore, kabllore, IPTV dhe internet TV.

Në zbatim të Metodologjisë së monitorimit, AMA ka përcjellë çdo ditë në KQZ, raportin ditor të monitorimit, me të dhënat e mëposhtme:

- Kohën e monitorimit të secilit prej OSHMA-ve në monitorim, për transmetimet nga ora 08:00 - 00:00;
- Minutazhin e transmetimeve për secilin subjekt zgjedhor;
- Hapësirën për çdo aktor politik;
- Radhën e vendosjes së kandidatëve në edicionet informative;
- Transmetimet live;
- Raportin gjinor të mbulimit të mediatic të kandidatëve.

Në raportet ditore të monitorimit të depozituara në KQZ, janë prezantuar problematikat e konstatuara në subjektet e monitoruara.

Ky raport përmbledhës përmban të dhëna mbi:

- Kohën e monitorimit të OSHMA-ve gjatë gjithë fushatës zgjedhore, për transmetimet e lajmeve, hapësirën për çdo aktor politik;
- Kohën e monitorimit të OSHMA-ve, për transmetimet e emisioneve, gjatë gjithë fushatës zgjedhore;

- Reklamata politike, në periudhën 26 mars -23 prill 2021;
- Raportin gjinor të mbulimit të mediatik të kandidatëve;
- Publikimin e sondazheve zgjedhore jashtë kohës së lejuar;
- Respektimin e heshtjes zgjedhore.

I. Përmbledhja e të dhënave mbi edicionet informative

Neni 81 i Kodit Zgjedhor parashikon se *në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Ky detyrim vlen edhe për subjektet audiovizivë privatë.*

Në tabelën nr. 1, bashkëlidhur pasqyrohet koha e plotë e subjekteve politike në edicionet informative të OSHMA-ve që janë në monitorim të përhershëm, për periudhën 26 mars 2021 – 23 prill 2021. Ndërsa në tabelën nr. 1.2, bashkëlidhur pasqyrohet koha e plotë e subjekteve politike në edicionet informative të OSHMA-ve, të përfshirë në monitorim me përzgjedhje, bazuar në kriteret e metodologjisë, periudhën 26 mars - 23 prill 2021.

II. Përmbledhja e të dhënave mbi emisionet

Në tabelën Nr. 2/1, “Emisionet”, jepen të dhëna përmbledhëse për periudhën 26 mars – 23 prill 2021, mbi kohën që iu kanë dhënë OSHMA-të, subjekteve politike gjatë emisioneve dedikuar fushatës zgjedhore.

III. Përmbledhja e të dhënave mbi reklamata politike

Neni 84 i Kodit Zgjedhor parashikon kushtet e transmetimit të reklamave politike. Në këtë dispozitë parashikohet se:

“4. ... Reklama politike duhet të identifikojë qartë subjektin porosites. Në rast se reklama politike nuk është identifikuar qartë, KQZ-ja urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë.

5. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje. ...”

6. Reklamata politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15:00 deri 18:00 dhe nga ora 21:00 deri 24:00 të programit ditor.”

Në datën 23 prill 2021, në OSHMA-të Top Channel dhe Report TV është identifikuar transmetimi i një reklame politike, bashkëlidhur CD, e cila jep udhëzime mbi mënyrën e votimit në datën 25 prill 2021. AMA ka dalluar në përmbajtjen e saj se ka elementë të çorientimit për ata që e ndjekin. Duke ju përcjellë përmbajtjen e kësaj reklame, AMA propozon vlerësimin e saj nga KQZ.

Në tabelën Nr. 3, “Reklamat” jepen të dhëna përmbledhëse për transmetimin e reklamave politike në periudhën 26 mars – 23 prill 2021. Në raportet ditore të periudhës 26 mars – 23 prill 2021, AMA ka përcjellë pranë KQZ-së gjetjet e identifikuara për çdo OSHMA.

IV. Raporti i përfaqësimit gjinor në fushatë

Sa i takon vlerësimin gjinor të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për gjithë fushatën elektorale, (pasqyruar përmbledhtazi në Tabelën nr. 4), për periudhën 26 mars – 23 prill 2021, ka rezultuar se vetëm një pjesë e OSHMA-të e kanë respektuar raportin e përfaqësimit gjinor në pasqyrimin e fushatës zgjedhore.

V. Respektimi i heshtjes zgjedhore

Neni 77 i Kodit Zgjedhor parashikon:

“2. Dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.”

Më datë 24 prill 2021, ditën e shtunë, RTSH 2 nga ora 10:02 deri në 10:32, ka transmetuar edhe kronika mbi aktivitetin e subjekteve politike në fushatë elektorale. Po në këtë datë, një kanal tjetër i operatorit publik, RTSH Kukësi, nga ora 08:11 deri në 08:15 ka transmetuar dy kronika mbi aktivitetin e subjekteve politike në fushatë elektorale.

Propozim V/1:

AMA i propozon KQZ-së marrjen e masave administrative për dy kanalet e sipërcituara të RTSH-së.

VI. Publikimi i sondazheve zgjedhore jashtë kohës së lejuar

Neni 78 i Kodit Zgjedhor përcakton se:

“... 4. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit...”

Nga monitorimi është konstatuar se heshtjen e ka thyer në datë 22 prill 2021, subjekti ABC News. Ky subjekt, nga ora 19:16 deri më 19:36, ka publikuar rezultatet e një sondazhi zgjedhor, në një kohë kur kjo është e ndaluar, bazuar në nenin 78, pika 4 të Kodit Zgjedhor.

Propozim VI/1:

AMA i propozon KQZ-së marrjen e masës administrative për OSHMA, TV ABC News.

Bashkëlidhur, këtij vendimi gjenden tabelat kumulative për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në periudhën 26 mars – 23 prill 2021, të cilat janë të bazuara në raportimet ditore që AMA ka dorëzuar pranë KQZ-së dhe që janë publikuar periodikisht në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.

Në pikën 2 të nenit 10 të metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive, parashikohet se: “AMA i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara (sasiore dhe cilësore),

minimalisht një herë në javë, të cilat ia paraqet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë”,

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 77-84 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive”,

V E N D O S I:

1. Miratimin e raportit të tabelave përmbledhëse të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26 mars - 23 prill 2021.
2. T’i propozojë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:
 - 2.1 Marrjen e masave administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor ndaj OSHMA-së, ABC News, për publikimin e rezultateve të sondazheve zgjedhore jashtë kohës së lejuar.
 - 2.2 Marrjen e masës administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor ndaj OSHMA, RTSH-së, për thyerje të heshtjes zgjedhore.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e vendimit të mësipërm, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA